

VENDIM
Nr.480, datë 16.7.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË BAJRAM CURRIT TË
MJEDISEVE TË ISH-SHTABIT TË BRIGADËS SË KËMBËSORISË NR.2230 NË BAJRAM
CURRI TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli të Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-shtabit të brigadës së këmbëtorisë nr.2230 në qytetin e Bajram Currit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Bajram Currit, për t’u përshtatur për çerdhe dhe konvikt për nevojat e komunitetit.

2. Prona me numër rendor 497, “Ish-shtabi i brigadës së këmbëtorisë nr.2230” në qytetin e Bajram Currit, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Bajram Currit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ia japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Bajram Currit të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano